Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0785

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Isa Hasani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE)"Runway" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me rroba civile dhe kepuce per femra - Ritender "me nr. të prokurimit:"214-23-7681-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves, me datën, 11.01.2024, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet**,** si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Runway" SH.P.K.,numër protokolli; 785/2023, kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me rroba civile dhe këpucë për femra - Ri tender " me numër të prokurimit: "214-23-7681-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

2. Anulohet "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" i datës, 27.09.2023, për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës OE"Runway" SH.P.K, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.05.2023, Policia e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me rroba civile dhe këpucë për femra - Ritender"

me nr. të prokurimit: "214-23-7681-1-1-1". Ndërkaq me datën 27.09.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE"Runway" SH.P.K. me datën 02.10.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

AK- Policia e Kosovës merr vendim të refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE"Runway" SH.P.K. si dhe te mbetet ne fuqi vendimi mbi anulimin nga AK-Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit ne fjalë si dhe Policia e Kosovës te vazhdoje me tutje sipas LPP-se lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me rroba civile dhe këpucë për femra - Ritender" me numër te prokurimit: "214-23-7681-1-1-1" iniciuar nga Autoriteti Kontraktues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Runway" SH.P.K. me datën 12.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 785/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 161,505.00 € .

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Pretendimet ankimore te Operatorit Ekonomik "Runway" SH.P.K 2023/0785 si në vijim:

Pretendim 1.OE ankues ka pretenduar se: "Si pike e pare e eliminimit sipas AK-së është se ne atest nuk është specifikuar se është 100% lëkur këpuca e ofruar po shënon vetëm: lëkurë natyrale. Ky arsyetim nuk qëndron dhe është plotësisht ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se pasi kane mundur te sqarojnë ne baze te nenit 59.4 pasi atesti ka qene i dorëzuar me oferte dhe Laboratori është i akredituar AKja ka mundur ta pyesin laboratorin pasi ne atest shkruan Lëkurë natyrale dhe rezistencë ndaj ujit , gjithashtu ne atest shkruar edhe sipas cilës metode ju është bere atesti i dispuneshmeris se ujit. Ne qofte se AK-ja nuk ju beson atesteve te Laboratoreve te akredituar qe janë institucione te besuara te shteteve atëherë nuk duhet ti kërkoj si kritere te dosjeve te tenderit. Gjithashtu AK e Policisë se Kosovës ka mundur te kontaktojnë vete Laboratorit dhe ta sqaroj a janë rezistent ndaj ujit por kjo shifet qarte se ne atest shkruan, dhe nuk kane pas arsye për qa me sqaruar për këtë s'kan mundur mi shkrua laboratorit kur ka qene e cekur ne atest kjo nuk don koment qe kjo është e qëllimshme. Sipas kësaj përgjigjeje te AK-se mundesh me kuptuar se nuk kane njohuri komisioni I vlerësimit por as menaxheri I prokurimit nëse ceket nga Laboratori se lëkur është natyrale kjo është e kuptuar se është 100 % lëkurë por laboratory i Shqipërisë i ka termet profesionale dhe për këtë është dashur ti shkruajnë laboratorit se a është lëkura 100 %."

Pretendimi 2"Pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : "Ndërsa mostra e ofruar shtresën e gomës nuk është e bute dhe krijon zhurme ne ecjen per shkak te materialit te forte", ne kemi dorëzuar mostrën gome dhe konstatimi i komisionit te vlerësimit vetëm me shikim vizuale – me sy kjo është subjektive rreth këtij vlerësimi por për këtë kane mundur te dërgojnë ne Laboratore te akredituar ne rajon dhe jo te eliminojnë

kompaninë pa te drejt. Sa pre dijen e komisionit dhe menaxherit te Prokurimit qe lëshon kësi gabime amatareske askunde ne dosjen e tenderit nuk shkruan gome e "butë" por vetëm gome shikoni specifikat e dosjes se tenderit: Ø Të mos rrëshqasin dhe bëjnë zhurme gjatë ecjes-duhet të jenë me shtresë gome; Komisioni i vlerësimit asnjeri nga komisioni i vlerësimit nuk është i profesionit te caktuar dhe nuk kane te drejt te japin një vlerësim vizuale per gomën e këpucës pasi për këtë janë Laboratorët dhe institutet e licencuar për këtë janë licencuar nga autoritet e akredituara, gjithashtu si është e mundur komisioni i vlerësimit me jep një konstatim se goma nuk është e bute ky konstatim për kompaninë tone është paushall dhe diskriminues pasi nuk është kërkuar gome e bute por vetëm gome."

Përgjigje në pretendimet e OE "Runway" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0785 ka vlerësuar si në vijim:

Sa i përket pretendimit 1. ankimor që në A-testin e dorëzuar nga OE ankues, nuk është cekur se a janë këpucët 100% me lëkurë natyrale, eksperti shqyrtues sqaron që një nga specifikimet teknike të detyrueshme në DT për këpucët e verës, ka qenë që këpucët "Të jene 100 % nga materiali i lëkurës, te dëshmohet me a-test dhe rezistencë ndaj ujit ". OE ankues ka ofruar A-Testin në të cilin theksohet se këpucët janë me lëkurë natyrale por ky test nuk i përmbushë kriteret e Dosjes së Tenderit, ku është dashur të ceket se sa përqind lëkurë janë këpucët e ofruara. Mirëpo, duke marr parasysh që në A-test nuk është cekur asnjë përqindje as më e lartë e as më e ulët, mendimi i ekspertit është që sipas neni 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoritet Kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në mënyrë që të vërtetohet që sipas A-testit të dorëzuar, a janë këpucët 100% përqind më lëkurë natyrale dhe të kuptohet arsyeja se pse nuk është cekur kjo përqindje edhe në test. Andaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket Pretendimi 2. ankimor, pjesës tjetër të pretendimeve, Eksperti shyqrtues pas analizimit të pretendimeve ankimore, ka bërë kërkesë për ekspert teknik në fushën përkatëse, ekspert i cili do të shqyrtonte pretendimet në aspektin teknik në mënyrë që të jap përgjigje për pretendimet e ngritura, mirëpo duke marr parasysh se Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka ekspert teknik të kësaj fushe përkatëse dhe madje nuk posedon as laborator në të cilin do të ishte e mundur të realizoheshin këto teste, unë si ekspert shqyrtues nuk mund të jap përgjigje profesionale në këto pretendime të ngritura. Andaj, duke marr parasysh këtë situatë, unë si ekspert shqyrtues rekomandoj që lënda duhet të kthehet në rivlerësim dhe vlerësoj që Autoriteti Kontraktues, mostrat e pranuara duhet t'i dërgoj në ndonjë laborator të akredituar në mënyrë që të vërtetoj se a qëndrojnë mostrat tërësisht në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit apo ka ndonjë devijim prej tyre.

Rekomandimi ekspertit; Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar dhe të anulohet vendimi i AK. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik ankues ka njoftuar se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit ekonomik "Runway" SH.P.K.", Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, " i datës,27.09.2023, për anulim të aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me rroba civile dhe këpucë për femra - Ri tender " me nr. të prokurimit: "214-23-7681-1-1-1", Raportin e Vlerësimit Tenderëve i datës 27.09.2023, për aktivitetin e dhe Vendimin e |Autoritetit kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, i datës, 05.10.2023.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit ekonomik ankues Runway" SH.P.K.", raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit ekonomik "Runway" SH.P.K.", janë konstatuar si pjesërisht të bazuara.

Andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të aprovuar ankesën e Operatorit ekonomik "Runway" SH.P.K.", te anulohet "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 27.09.2023, për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr: "214-23-7681-1-1-1" dhe lënda, aktiviteti i prokurimit, kthehet në Ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik lidhur me anulimin e aktivitetit prokurimit pasi Njoftimi për anulim nuk është ne përputhje me depozitat ligjore, pasi nuk ka treguar bazën ligjore te anulimit, neni 43.1 i Rregullores për Prokurim Publik përcakton" Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikoj Formularin B58 "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesës së Operatorit ekonomik "Runway" SH.P.K.", vendos ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga OE ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **RUNWAY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: